

## Programi Kursim për Kolegj

### Njoftim dhe Formular për Heqje Dorë (Opt-Out) për Prindërit dhe Kujdestarët

3 Nëntor 2025

I nderuar prind/kujdestar:

Shkollat Publike të Nju Jorkut ("NYCPS") kanë bashkëpunuar me organizatën jofitimprurëse NYC Kids RISE, Inc. për Programin e Kursimit për Kolegj të NYC Kids RISE ("Programi"). Ky program falas u ofron nxënësve që kualifikohen mbështetje financiare për shpenzime të përshtatshme për kolegje ose trajnim profesional. NYC Kids RISE cakton 100 dollarë për secilin nxënës në Program në një "Llogari Bursash të NYC (NYC Scholarship Account)". Në varësi të financimit, Qyteti i Nju Jorkut dhe NYCPS po vazhdojnë ta zgjerojnë Programin këtë vit shkollor dhe shkolla e fëmijës suaj do të përfshihet. Për më shumë informacion, vizitoni <http://nyckidsrise.org>.

Ky Njoftim përmban informacion të rëndësishëm mbi mënyrën se si të veproni: (1) të mos bëni asgjë dhe të pranoni që NYC Kids RISE të krijojë një Llogari Bursash të NYC (NYC Scholarship Account) për fëmijën tuaj OSE (2) të hiqni dorë (opt out) dhe të mos lejoni që NYC Kids RISE të krijojë një Llogari Bursash të NYC për fëmijën tuaj.

**Që fëmija juaj të ketë një Llogari Bursash të NYC, NYCPS duhet të ndajë informacionin vijues me NYC Kids RISE dhe një kompani të quajtur VistaShare:**

- Një numër identifikimi të nxënësit i cili është unik për Programin
- Emri i plotë i nxënësit
- Data e lindjes së nxënësit
- Adresa e banimit të nxënësit dhe çdo ndryshim i ardhshëm
- Numri i telefonit të shtëpisë
- Emri i shkollës
- Klasa aktuale
- Gjuha(t) që flitet në shtëpi
- Transferimet e bëra në shkolla të tjera, nëse ka, brenda ose jashtë sistemit të shkollave publike të NYC
- Numri i identifikimit të prindit/kujdestarit unik për Programin
- Emri i plotë i prindit/kujdestarit
- Adresa e emailit e prindit/kujdestarit
- Numri i celularit dhe/ose një numër tjetër telefoni i prindit/kujdestarit

NYC Kids RISE bashkëpunon me VistaShare për të ruajtur informacionin e pjesëmarrësve, për të menaxhuar një portal online dhe për të ofruar mbështetje teknike. NYC Kids RISE dhe VistaShare lejohen ta përdorin ose ta ndajnë këtë informacion vetëm për të zbatuar dhe vlerësuar Programin. Ato nuk lejohen ta shesin, ta përdorin apo ta ndajnë këtë informacion për ndonjë qëllim reklamues, marketingu apo qëllime të tjera tregtare.

**Çfarë opsionesh keni?**

1. **MOS BËNI ASNJË GJË (mos plotësoni dhe mos ktheni formularin në faqen tjetër) nëse dëshironi që fëmija juaj të marrë pjesë dhe të ketë 100 dollarë të caktuar në një Llogari Bursash të NYC (NYC Scholarship Account) të krijuar dhe administruar nga NYC Kids RISE në emër të fëmijës suaj.**

**OSE**

2. **HIQNI DORË (OPT OUT) duke plotësuar formularin në faqen tjetër dhe duke e kthyer atë në zyrën kryesore të shkollës suaj deri më 12/3/2025 nëse NUK dëshironi të merrni pjesë. Fëmija juaj nuk do të marrë një Llogari Bursash të NYC dhe informacioni i tij/saj nuk do të ndahet në lidhje me Programin. Ju lutemi flisni me zyrën kryesore të shkollës tuaj nëse keni pyetje rreth plotësimit të formularit të heqjes dorë (opt-out) në faqen tjetër.**

**Keni pyetje rreth Programit? Telefononi linjën telefonike të NYC Kids RISE në 833-543-7473 ose dërgoni email te NYCPS në [SavingTogether@schools.nyc.gov](mailto:SavingTogether@schools.nyc.gov).**

**Formulari i Heqjes Dorë nga Programi Kursim për Kolegj**

**OFFICE NOTE: For kindergarten and newly enrolled first, second, and third graders only. Keep all returned Opt-Out Notices in the student's Cumulative Folder indefinitely. T-39244 ALBANIAN | Page 1 of 2**

## Programi Kursim për Kolegj

### Njoftim dhe Formular për Heqje Dorë (Opt-Out) për Prindërit dhe Kujdestarët

Plotësoni dhe nënshkruani këtë formular vetëm nëse NUK dëshironi që fëmija juaj të marrë një Llogari Bursash të NYC. Kthejeni te sekretariati i shkollës suaj deri më 12/3/2025.

Si prind/kujdestar i fëmijës tim, NUK DUA që informacioni i fëmijës tim të ndahet me NYC Kids RISE ose VistaShare. UNË E KUPTOJ që duke mos ndarë këtë informacion, fëmija im NUK do të marrë një Llogari Bursash të NYC dhe nuk do të caktohen para për fëmijën tim.

|                             |                                                         |
|-----------------------------|---------------------------------------------------------|
| Emri i Nxënësit:            | Mbiemri i Nxënësit:                                     |
| Emri i Shkollës:            | Klasa Zyrtare e Fëmijës:<br><br>Niveli Zyrtar i Klasës: |
| Emri i Prindit/Kujdestarit: | Nënshkrimi:                                             |
| Data:                       |                                                         |